



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT  
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVA - URED PRESEDNIKA

## KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM EVROPIAN

Shtojca 1

### **Përfundimet e takimit inaugurues** **27 mars 2012, Prishtinë**

1. Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian mirëpret fillimin e Studimit të Fizibilitetit për Kosovën. Këshilli shpreh besimin që studimi të përfundojë brenda një afati sa më të shkurtër kohor dhe të adresojë çështjet kryesore që do të mundësojnë vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Të arrihet progres në fushën e tregtisë, në reformën e administratës publike, në reformën zgjedhore, në sundimin e ligjit dhe në integrimin e plotë të komuniteteve;
2. Këshilli mirëpret fillimin e dialogut për liberalizim të vizave dhe dhënien sa më të shpejtë të udhërrëfyesit për Kosovën, që pas përmbushjes së kriterëve të caktuara do të iu mundësojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë pa viza në shtetet e zonës së Shengenit. Këshilli konsideron që është e një rëndësie të veçantë që procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën të jetë në një vijë me politikën e zgjerimit të BE-së dhe perspektivën evropiane të rajonit. Të vazhdohet me reforma në fushën e sigurisë së dokumenteve, menaxhimin e kufirit dhe migracionit, të drejtave fundamentale dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit;
3. Këshilli vlerëson progresin në përmbushjen e parakushteve drejt marrëveshjes për tregti të lirë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, dhe konsideron këtë si hap të rëndësishëm për nxitjen e investimeve të huaja dhe krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillim ekonomik të vendit. Të plotësohen rekomandimet e Komisionit Evropian të vitit 2011, dhe përgatitjet për ardhjen e misionit tregtar që do të fillojë në fund të qershorit 2012.
4. Këshilli mbështet nismën e Ministrisë së Integritimit Evropian për krijimin e Task Forcës për Integrim Evropian me qëllim të hartimit të Strategjisë

Kombëtarë për Integrim Evropian, duke siguruar konsensus të plotë me të gjithë akterët e shoqërisë kosovare të involvuar në këtë proces;

5. Këshilli përshëndet angazhimin dhe përkushtimin e të gjithë akterëve relevant të shoqërisë në zbatimin e kritereve dhe përmbushjen e obligimeve për anëtarësim të Republikës së Kosovës në BE.

#### **RREGULLAT E PROCEDURËS**

6. U propozua që Rregullat e procedurës të Këshillit të modifikohen duke përfshirë si anëtar të përhershëm të Këshillit edhe Kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.